



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA E PËRGJITHSHME  
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 1079 | prot.  
2

Tiranë më, 17.07. 2020

## UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

Nr. 10, datë 17. 07. 2020

**PËR  
MASAT ADMINISTRATIVE DHE PROCEDURALE  
PËR RRITJEN E EFEKTIVITETIT NË LUFTËN KUNDËR PASTRIMIT TË  
PARAVE, KRIMEVE FINANCIARE, FINANCIMIT TË TERRORIZMIT DHE NË  
HETIMET PASURORE NË PROKURORITË E JURIDIKSIONIT TË  
PËRGJITHSHËM**

Në mbështetje, të neneve 148 pikat 1, 2, 3 e 148/b shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 38 pika 2 shkronjat “b” e “f”, 4, 5, 6, 21, 42 shkronja “a”, “c”, “g”, 43, 46 pikat 1, 2, 3 shkronjat “c<sup>1</sup>” e “ç” e 4, 48 e vijues të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, neneve 3, 4, 5, 6, 7, 11, 21, 24 e vijues të ligjit nr.10192<sup>2</sup>, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korruptionit dhe krimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar, neneve 24, 25, 190, 274, 287, 323 e vijues të ligjit nr.7905/1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neneve 36, 287, 230/a e vijues të ligjit nr.7895/1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neneve 101 e 102 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rekomandimeve të KSA<sup>3</sup>-së e FATF dhe Planit Veprimit të ICRC/FATF<sup>4</sup> dhe Memorandumin e

<sup>1</sup> Shih, Rekomandimet Prioritare për Prokurorin e Përgjithshëm në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020 të miratuara me vendimin nr.501 datë 24.06.2020 të Këshillit të Ministrave (-rritia e efektivitetit ne lufthen kundë pastrimit të parave, krimeve financiare, hetimet pasurore, -lidhja e tyre me trafiqet e paligjshme dhe krime te tjera te randa; -rritia e efektivitetit të bashkepunimit me agjensite e zbatimit të ligjit; -rritia e bashkëpunimit me autoritetet gjyqësore të huaja, etj).

<sup>2</sup> Shih, ligjin nr.10192/2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korruptionit dhe krimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar me ligjin nr.70/2017, datë 27.4.2017, hyrë në fuqi më datë 21.06.2017.

<sup>3</sup> Rekomandimet e takimit të 10-të të Komitetit të Stabilizim-Asociimit (KSA), midis Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian mbajtur më 14 nëntor 2019 në Bruksel, ndër të cilët janë: “-Shqipëria inkurajohet të intensifikojë më tej luftën kundër pastrimit të parave dhe të gjitha veprimet kundër të ardhurave nga krimi; - Në lidhje me pjesën e efektivitetit të rekomandimeve të MONEYVAL, Shqipëria do të ndjekë përpjekjet për të kryer hetime paralele mbi financimin e terrorizmit;”

<sup>4</sup> Vendimi i Komitetit të Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave nr.1 datë 19.02.2020 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për ndjekjen dhe përbushjen e rekomandimeve të Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar”, dhe “Plani i veprimit”/ “Action plan”

Bashkëpunimit nr.1079, datë 15.07.2020 mes palëve Prokurori i Përgjithshëm, Ministri i Financave dhe Ekonomisë (përfshirë DPPP, DPD e DPT) dhe Ministri i Brendshëm (përfshirë DPPSH e AAPSK) “*Për rritjen e efektivitetit në hetimet që lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, krimet financiare dhe sekuestrimin e konfiskimin e aseteve kriminale, në funksion të përmbushjes së rekomandimeve të KSA-së e FATF-së dhe Planit të Veprimit ICRG/FATF*”;

## U D H Ë Z O J:

### KREU I

### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

#### Qëllimi

Ky udhëzim i përgjithshëm ka për qëllim të normojë dhe unifikojë masat administrative dhe procedurale penale në prokuroritë pranë gjykatave të juridiksimit të përgjithshëm përritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, kimeve financiare dhe në hetimet pasurore për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale, në respektim të parimeve të ligshmërisë, detyrueshmërisë së ndjekjes penale dhe pavarësisë/autonomisë së prokurorit në ushtrimin e ndjekjes penale<sup>5</sup> si dhe në përqasje me rekomandimet<sup>6</sup> dhe standartet evropiane<sup>7</sup>.

Ky udhëzim synon përmirësimin e cilësisë dhe plotshmërisë sipas tipologjive të, kallëzimeve penale ose referimeve dhe hetimeve të kryera nga policia gjyqësore në strukturat hetimore përkatëse dhe vlerësimit nga prokuroria të provave/indicieve që provojnë rrëthanat e faktit dhe ligjin e zbatueshëm për regjistrimin e procedimit, kryerjen e hetimeve, ndjekjen penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq, për: -përmbushjen e rekomandimeve të FATF-së dhe KSA<sup>8</sup>-se, -rritjen e efektivitetit në, hetimet që lidhen me pastrimin e parave, përfshi tipologjitë e rekomanduara, kimeve financiare, financimin e terrorizmit përfshi hetimet paralele të rekomanduara, hetimet pasurore për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive produkt i veprës penale penale ose i veprimtarisë kriminale,

---

<sup>5</sup> Shih, nenin 4 “Ligjshmëria e veprimtarisë”, nenin 5 “Detyrueshmëria e ndjekjes penale”, nenin 6 “Pavarësia e prokurorëve” të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>6</sup> Shih, rekomandimet e Komisionit të Stabilizim Asocimit të BE – Shqipëri datë 14 Nëtor 2019 dhe rekomndimet e Planin e Punës të ICRC/FATF për Shqipërinë.

<sup>7</sup> Shih, Direktivën (BE) 1673/201 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit datë 23 Tetor 2018 “*Për luftën kundër pastrimit të parave sipas ligjit*”

<sup>8</sup> Rekomandimet e takimit 10-të Komitetit të Stabilizim-Asociimit (KSA), midis Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian mbajtur më 14 nëntor 2019 në Bruksel, ndër të cilët janë: “-Shqipëria inkurajohet të intensifikojë më tej luftën kundër pastrimit të parave dhe të gjitha veprimet kundër të ardhurave nga krimi; -Në lidhje me pjesën e efektivitetit të rekomandimeve të MONEYVAL, Shqipëria do të ndjekë përpjekjet për të kryer hetime paralele mbi financimin e terrorizmit;”

veçanërisht tipologjitet e rekomanduara<sup>9</sup> (-palët e treta të pastrimit të parave, -subjekte të posaçëm/profesionist dhe nga vetë subjektet raportuese (gatekeeper) si dhe -aseteve që përfaqësojnë të ardhura indirekte dhe/ose vlerë ekuivalente);

## Neni 2

### Objekti

1. Objekt i këtij udhëzimi të përgjithshëm janë:

a) Përcaktimi i masave administrative për:

i) Organizimin e seksioneve të posaçme kundër pastrimit parave, financimit të terrorizmit, kimeve financiare dhe hetimeve pasurore (në vijim seksionet e posaçme) nga drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë të juridikzionit të përgjithshëm sipas rregullores standard të organizimit dhe funksionimit të prokurorive;

ii) Kriteret e përzgjedhjes së prokurorëve që do të ushtrojnë funksionet në këto seksione;

iii) Caktimin e pikave të kontaktit, rolit dhe detyrave të tyre në prokuroritë me juridiktion të përgjithshëm dhe në Prokurorinë e Përgjithshme;

iv) Trajnimin e prokurorëve të seksionit për forcimin e kapaciteteve profesionale nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta trajnuese me oficerët e policisë gjyqësore të strukturave hetimore përkatëse dhe me punonjësit e institucioneve apo agjencive ligjzbatuese të përfshira.

b) Përcaktimi i masave procedurale penale lidhur me:

i) Veprat penale në kompetencë lëndore të seksionit kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, kimeve financiare dhe hetimeve pasurore si dhe standartet evropiane për kuptimin, interpretimin e zbatimin e tyre;

ii) Masat procedurale që marrin oficerët e policisë gjyqësore të strukturës hetimore përkatëse, prokurorët, drejtuesi i seksionit dhe/ose prokurori i caktuar në prokurorinë përkatëse aty ku nuk ka seksione:

-në hetimin dhe ndjekjen penale të veprave, objekt i këtij udhëzimi të përgjithshëm sipas fazave të procedimit penal;

-në hetimet pasurore për pasuritë produkt të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, në kompetencë lëndore të prokurorive me juridiktion të përgjithshëm, si në zbatim të K.Pr.Penale, ashtu dhe në zbatim të ligjit nr.10192/2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korruptionit dhe kimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”<sup>10</sup>.

<sup>9</sup> Vendimi i Komitetit të Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave nr. 1 datë 19.02.2020 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për ndjekjen dhe përbushjen e rekomandimeve të Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar”, dhe “Plani i veprimit”/ “Action plan”

<sup>10</sup> Shih nenin 3 “Fusha e veprimit” dhe nenin 7 “Kompetenca dhe përbërja e gjykatës” të ligjit nr.10192/2009, ndryshuar me ligjin nr.70/2017, në të cilin parashikohet se:

“-Neni 3 “Fusha e veprimit”, për kompetencën lëndore të prokurorive me juridiktion të përgjithshëm, parashikon:

“ 1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për pasuritë e personave, që zotërohen plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, siç përcaktohet në pikën 2, të këtij neni, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në indicie, për:

b) pjesëmarje dhe kryerje të kimeve për qëllime terroriste, parashikuar nga kreu VII i Kodit Penal;

c) kryerjen e kimeve të parashikuara në nenet 109, 109/b, 110/a, 128/b, 278/a, 282/a, 283, 283/a të Kodit Penal;

c) Përcaktimi i rregullave dhe afateve për informimin dhe për ruajtjen e sekretit hetimor, ndalimin e publikimit të akteve dhe mbrojtjen e të dhënavë personale nga prokurorët dhe/ose drejtuesi i seksionit përkatës.

### Neni 3

#### Përkuftizime

Në këtë udhëzim, termat apo emërtimet kanë kuptimet, si më poshtë:

1. “Veprimtari kriminale<sup>11</sup>” nënkupton çdo lloj përfshirjeje kriminale në kryerjen e veprës penale që parashikon dënim me burgim në maksimum më shumë se një vit. Në çdo rast, veprat penale brenda kategorive të mëposhtme konsiderohen aktivitet kriminal:

a) Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, neni 287 i Kodit Penale, ku përfshihen edhe ato sipas tipologjive:

i) për vepër penale bazë me kallëzim të huaj;

ii) pastrimi i parave të palëve të treta nga profesionistë;

iv) pastrimi i parave i pavarur nga ndonjë vepër kryesore/bazë, mbështetur në prova rrrethanore.

b) Përvetësimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale, neni 287/b i Kodit Penal;

---

c) pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal;

d) kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet 164/a, 164/b, 183, 256, 257/a, të Kodit Penal, në rastet kur ekzistojnë indicie për përfitim pasuror të paligjshëm.

2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj pasurive të personave të përmendur në pikën 1, të këtij neni, në pronësi ose të zotëruara në mënyrë të tërthortë nga:

a) personat e afërm (bashkëshorti, fëmijët, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit, motrat, bashkëjetuesi), për të cilët prezumohet regjistrimi i rremë, përveçse kur provohet e kundërtë;

b) personat fizikë ose juridikë, për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme se pasuritë ose veprimtaritë e tyre zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të tërthortë nga personat e përmendur në pikën 1, të këtij neni, ose janë përdorur, kanë lehtësuar apo kanë ndikuar në një formë të caktuar në kryerjen e veprimtarive të jashtëligjshme prej tyre.

3. Prezumimi i regjistrimit të rremë të pasurive dhe veprimtarive ekonomike të personave të përmendur në pikën 1, të këtij neni, në emër të personave të afërm, të përmendur në shkronjën “a”, të pikës 2, të këtij neni, zbatohet kur ka të dhëna të dobishme, të siguruara në rrugë të ligjshme, të cilat krijojnë dyshimin e arsyeshëm për paligjshmérinë e origjinës së pasurisë.

4. Të dhënët e mjaftueshme që pasuritë ose veprimtaritë e personit fizik ose juridik të përmendur në shkronjën “b”, të pikës 2, të këtij neni, zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të tërthortë, nga personat e përmendur në pikën 1, të këtij neni, nxirren nga marrëdhënia ndërmjet personit fizik dhe juridik me personat e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, dhe nga të dhëna të dobishme, të siguruara në rrugë të ligjshme, të cilat krijojnë dyshimin e arsyeshëm për paligjshmérinë e origjinës së pasurisë.

5. Masat parandaluese mund të kërkohen dhe ndaj trashëgimitarëve të personit, subjekt i zbatimit të këtij ligji, por, në çdo rast, jo më vonë se 5 vjet nga data e vdekjes.

6. Ky ligj zbatohet edhe për pasuritë e personave, të vëna përparrë hyrjes në fuqi të tij, me kusht që të ekzistojnë indicie të rëndësishme për përfshirjen e tyre në veprimtari kriminale, në kohën e vënies së pasurisë.

-Neni 7 “Kompetenca dhe përbërja e gjykatës” pika 1 parashikon:

“1. Kërkesa për marrjen e masave parandaluese, sipas këtij ligji, shqyrtohet në shkallë të parë, nga gjykata e rrithëve gjyqësore...

2. Kërkesa për marrjen e masave parandaluese shqyrtohet në shkallë të dytë, nga gjykata e apelit...

3. Zbatohen, për aq sa janë të pajtueshme, dispozitat e paragrafit 1, të nenit 80, të Kodit të Procedurës Penale.”

<sup>11</sup> Shih, nenin 2 pika 1 e Direktivës (BE) 1673/201 të Parlamentit European dhe Këshillit datë 23 Totor 2018 “Për luftën kundër pastrimit të parave sipas ligjit”.

- c) Vepra penale në fushën e tatim - taksave, nenet 180, 181, 181/a të K.Penal;
- ç) Vepra penale kryera në shoqëritë tregtare nenet 164-170/ç të K.Penal;
- d) Vepra penale në fushën e doganave, nenet 171-179/ç të K.Penal;
- dh) Financimi i terrorizmit, neni 230/a i Kodit Penale;
- e) Fshehja e fondeve dhe e pasurive të tjera që financojnë terrorizmin, neni 230/b i Kodit Penal;
- ë) Vepra penale të tjera, kompetencë lëndore të prokurorive pranë gjykatave të rrithit gjyqësor<sup>12</sup>, kryerja e të cilave sjell pasuri/asete që janë produkt i veprës penale.

2. "Pasuri" është çdo fond apo pasuri, përfshirë, por jo vetëm, pasuri financiare, burime ekonomike, prona të çfarëdo lloji, të prekshme apo të paprekshme, të luajtshme apo të paluajtshme dhe dokumente ligjore apo instrumente të çfarëdo forme, përfshirë ato elektronike apo digitale, që dëshmojnë tituj pronësie apo interes në fonde të tilla apo pasuri të tjera përfshirë, por jo vetëm, kreditë bankare, çeqe udhëtarësh, çeqe bankare, urdhra për pagesë paraje, aksione, letra me vlerë, bono, drafte, apo letra krediti, dhe çfarëdo interes, dividendë apo të ardhura të tjera në to, apo vlera që rrjedhin apo të gjeneruara nga fonde të tilla apo pasuri tjera, të përvetësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë, apo të tërthortë përmes veprës penale dhe çfarëdo të ardhurash në të cilat është shndërruar apo përzier dhe fondet apo pronat terroristë;

3. "Pastrimi i parave"<sup>13</sup> është procesi i fshehjes ose maskimit, të parave të pista të fituara nga aktivitete kriminale, të aseteve të fituara nga përdorimi i parave të pista dhe të identitetit të pronarit përfitues.

4. "Hetimi finanziar" është kontrolli i hollësishëm, në lidhje me sendet/mjetet e kryerjes së veprës penale ose produktet e veprës penale, i pasurive në pronësi dhe/ose që ka në kontroll një individ apo kompania dhe një analizë e plotë e burimeve dhe shpenzimeve të fondeve që i përkasin një individi apo kompanie, në kuadrin e procedimit penal për sekuestrimin<sup>14</sup> dhe/ose konfiskimin<sup>15</sup> sipas nenenit 36 të Kodit Penal, ku përfshihen edhe ato sipas tipologjive: -pasuri/asete të palëve të treta, -të subjekteve të posaçëm/profesionist; -të vetë subjekteve raportuese (gatekeeper)<sup>16</sup> si dhe -aseteve që përfaqësojnë të ardhura indirekte, dhe/ose -vlerë ekuivalente.

<sup>12</sup> Shih, nenen 74 të K.Pr.Penale.

<sup>13</sup> Shih, "Perkufizimi teorik i vepres penale pastrimi i parave", faqe 19 në Manualin e Projektit të Binjakëzimit të BE "Mbështetje për strukturat e luftës kundër pastrimit të parave dhë strukturat e hetimit të kimeve financiare në Shqipëri".

<sup>14</sup> Shih, nenenit 274 e vijues të K.Pr.Penale.

<sup>15</sup> Shih, po aty nenen 190 pika 1 shkronja "a".

<sup>16</sup> Shih, Direktivën (BE) 2015/849 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 20 Maj 2015 "Për parandalimin e përdorimit të sistemit finanziar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, ... , e cila në nenen 2 pika 1 parashikon: "1. Kjo Direktivë do të zbatohet detyrimisht për entitetet e mëposhtme

- (1) institucionet e kreditit;
- (2) institucionet financiare;
- (3) personat fizikë ose juridikë vijues që ushtrojnë veprimtarinë e tyre profesionale:
  - (a) auditorë, llogaritarët e jashtëm dhe këshilltarët e taksave;
  - (b) noterët dhe profesionistët e tjera të pavarur juridikë, kur ata marrin pjesë, qoftë duke vepruar në emër të klientit të tyre në ndonjë transaksion financier ose të pasurive të patundshme, ose duke ndihmuar në planifikimin ose kryerjen e transaksioneve për klientin e tyre në lidhje me:
    - (i) blerjen dhe shitjen e pasurive të paluajtshme ose të subjekteve afariste;
    - (ii) administrimi i parave, letrave me vlerë ose pasurive të tjera të klientit;
    - (iii) hapja ose administrimi i llogarive bankare, të kursimeve ose letrave me vlerë;
    - (iv) organizimi i kontributeve të nevojshme për krijimin, funksionimin ose administrimin e kompanive;
    - (v) krijimin, funksionimin ose administrimin e besimeve, kompanive, fondacioneve ose strukturave të ngjashme;

5 “Verifikimi paraprak”<sup>17</sup> është procedura e verifikimit të të dhënave paraprake mbi ekzistencën e dyshimeve për aktivitet kriminal të subjektit dhe të pasurive në pronësi apo në posedim të tij, të dhëna të cilat mundësojnë regjistrimin e hetimit pasuror në zbatim të ligjit nr.10192/2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimtit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”, i ndryshuar.

5.1 “Hetimi pasuror”<sup>18</sup>, është procedura për verifikimin/hetimin dhe sekuestrimin e pasurisë në zbatim të ligjit nr.10192/2009, i ndryshuar.

5.2 “Gjykim pasuror”<sup>19</sup> është procedura që nis me dërgimin e kërkesës për konfiskim në gjykatë për pasuritë, veprimtaritë ekonomike dhe profesionale, të personave sipas nenit 3 e vijues të ligjit nr.10192/2009, kur plotësohen të gjitha kushtet, siç janë:

a) ka dyshime të arsyeshme, të bazuara në indicie, për pjesëmarrje të personit në veprimitari kriminal, të parashikuara në nenin 3, pika 1, të këtij ligji;

b) rezulton se pasuria është, drejtësorejt ose têrthorazi, në zotërim të plotë ose të pjesshëm të personave të përmendur në nenin 3, pika 1, të këtij ligji;

c) nuk provohet se pasuria ka prejardhje të ligjshme apo personat e përmendur në nenin 3, të këtij ligji, nuk arrijnë të përligjin zotërimin e pasurive ose të ardhurave, të cilat janë shpërpjesëtimore me nivelin e të ardhurave apo fitimeve të realizuara nga burime të ligjshme të deklaruara prej tyre.

6. “Prova rrethanore”<sup>20</sup> apo “rrethana fakti objektive”<sup>21</sup> në kuptim të nenit 287 të Kodit Penal, por jo vetëm, mund të jenë:

a) Rritja e pajustifikuar e aseteve/pasurisë.

b) Kryerja e operacioneve të pazakonta financiare, ndër të cilët mund të jenë:

i) Krijimi i përsëritur dhe/ose likuidimi i kompanive të ndryshme;

ii) Menaxhimi i shumave të larta të pazakonta të parave (*cash*);

iii) Përdorimi i korporatave false dhe atyre sa për dukje/figurë që ta bëjnë sa më të vështirë për autoritetet të identifikojnë personat të cilët janë *de facto* ata që kontrollojnë operacionet;

iv) Mosmbajtjen e takimeve të aksionarëve në rast të “korporatave guaska” gjë që tregon qartë se këto kompani nuk menaxhohen nga aksionarët formalë;

v) Ekzistenza e regjistrave të parregullta në dokumentacionin e tyre kontabël;

vi) Depozitimi i parave në banka në mënyrë të pjesshme, e cila nuk i bindet një dinamike të arsyeshme;

vii) Përdorimi i letrave false të cilat justifikojnë importin e mallrave joekzistues;

viii) Hapja e llogarive bankare të njëpasnjëshme në intervale të shkurtra kohe.

c) Mungesa e aktivitetave ekonomike ose tregtare të cilat justifikojnë rritjen.

ç) Lidhja ose përfshirja në hallkat e aktivitetit kriminal.

c) siguruesit e shërbimeve të besimit ose kompanisë që nuk janë përfshirë tashmë në pikën (a) ose (b);  
(d) agjentët e pasurive;

(e) persona të tjerë që bëjnë tregti me mallra në masën që pagesa janë bërë ose pranuar me para në një shumë prej 10 000 EUR ose më shumë, pavarësisht nëse transaksiioni kryhet në një operacion të vetëm ose në disa operacione që duket se janë të lidhura;

(f) ofruesit e shërbimeve të lojërave të fatit. etj“

<sup>17</sup> Shih, nenin 8 në lidhje me nenin 3 e vijues të ligjit nr.10192/2009, i ndryshuar me ligjin nr.70/2017.

<sup>18</sup> Shih, nenin 6 në lidhje me nenin 3, 4, 5, 6, 7 e vijues të ligjit nr.10192/2009, i ndryshuar me ligjin nr.70/2017.

<sup>19</sup> Shih, nenet 21, 22, 24 në lidhje me nenin 3, 4, 5, 6, 7 e vijues të ligjit nr.10192/2009, i ndryshuar me ligjin nr.70/2017.

<sup>20</sup> Shih, po aty, “Prova rrethanore”, faqe 79-80 të Manualit.

<sup>21</sup> Shih, nenin 287 të K.Penal, paragrafi fundit, i cili parashikon: “Djenia dhe qëllimi, sipas paragrafit të parë të këtij neni, nxirren nga rrethana fakti objektive”

7. “Vepër penale kryesore”<sup>22</sup> është çdo vepër penale kryerja e të cilës ka krijuar produkt (pasuri/asete) që mund të bëhen objekt i formave të kryerjes së veprës penale pastrimi i parave ose financimi i terrorizmit.

8. “Hetime paralele” janë hetimet financiare ose pasurore që kryhen, për çdo vepër penale që krijon/prodhon produkt (pasuri/asete) kriminale, në kuadrin procedimit penal në zbatim të Kodit të Procedurës Penale<sup>23</sup> apo në zbatim të ligjit nr.10192/2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korruptionit dhe kimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”.

9. “Subjekte raportuese (gatekeeper)” janë institucionet shtetërore ose private, duke përfshirë, por jo vetëm, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Palujtshme, Drejtorinë e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Bankat, Qendrën Kombëtare të Regjistrat Tregtar, Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKL e QKR), Drejtorinë e Shërbimit të Transportit Rrugor, Drejtorinë e Tatimeve, Drejtorinë e Doganave, Agjencinë e Legalizimit Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave Ndërtimore Informale, Kapitenerinë e Porteve, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit në cilësinë e subjekteve raportuese që i shpërndajnë rezultatet/analizat e tyre tek institucionet relevante për qëllime të inteligencës apo për aktivizimin e hapave të veprimeve hetimore.

10. “Palë të treta të pastrimit parave” janë personat me lidhje familjare, miqësore, shoqërore ose persona të tjerë, të cilët fshehin, mbajnë, administrojnë, konvertojnë, tjetërsojnë ose përzgjedhjnë pasuri/asete për llogari të personit që i ka siguruar ato me pasuri/asete nga veprimtaria kriminale e kryer prej tyre ose në bashkëpunim me persona të tjerë.

11. “Palë të treta profesioniste të pastrimit parave”<sup>24</sup> janë profesionistët e pavarur ligjorë (avokati, noteri, eksperti kontabël apo këshilltarë për tatime, etj) të cilët, krahas ofrimit të këshillave ligjore apo financiare/tatimore, marrin pjesë në aktivitete të pastrimit të parave nëpërmjet këshillave ligjore apo financiare të ofruara prej tyre për qëllime të pastrimit të parave.

12. “Të ardhura indirekte të pastrimit parave” janë pasuri ose veprimtari që i përkasin personit që ka kryer dhe/ose kryen veprimtari kriminale, pasuri/veprimtari ekonomike që zotërohen, pjesërisht ose plotësisht në mënyrë të tërthortë për llogari të tij nga një person, personi fizik ose personi juridik.

13. “Vlerë ekuivalente/barazvlefshme e pastrimit të parave”<sup>25</sup> është vlera monetare ose çdo pasuri tjetër në zotërim të personit në kuadrin e një procedimi penal ose në kuadrin e një hetimi pasuror sipas ligjit nr.10192/2009, person i cili, pas marjes dijeni për hetimet në ngarkim të tij, tjetërsori, shpërndan, transferon, shpërdoron, fsheh ose zhvlerëson pasurinë produkt të veprës penale, me qëllimin për të shmangur sekuestrimin dhe/ose konfiskimin e saj.

14. “Track record” është forma e regjistrimit të ecurisë së rasteve dhe e informimit/raportimit në marrëdhëni të institucionale (midis prokurorive të rretheve

<sup>22</sup> Shih, nen 1 shkronja “e” e Konventës së Këshillit të Evropës , “*Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit*”, e ratifikuar me ligjin nr. 9646/2006.

<sup>23</sup> Shih, nenet 274, 190 e vijues të K.Pr.Penale dhe nenit 36 të K.Penal,

<sup>24</sup> Shih, nenin 2 të Direktivës (BE) 2015/849 lidhur me kryerjen e veprës penale në ushtrimin e veprimtarive profesionale nga profesionistët.

Gjithashtu, shih “Profesionist”, faqe 72,73, 88 të Manualit e Projektit të Binjakëzimit të BE “Mbështetje për strukturat e luftës kundër pastrimit të parave dhë strukturat hetimit të kimeve financiare në Shqipëri””.

<sup>25</sup> Shih, nenin 12/a të ligjit nr.10192/2009, ndryshuar me ligjin nr.70/2017.

gjyqësore me Prokurorinë e Përgjithshme) dhe ndërinstitucionale (midis Prokurorisë së Përgjithshme me organet dhe agjencitë ligjbatuese të përfshira).

## KREU II

### MASAT ADMINISTRATIVE

Neni 4

#### **Krijimi i sektioneve të posaçme**

1. Drejtuesit në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Fier, Vlorë e Korçë, krijojnë sektionin e posaçëm kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, kimeve financiare dhe hetimeve pasurore.

2. Në prokuroritë e tjera pranë gjykatave të shkallës së parë me juridikcion të përgjithshëm, ku nuk është e mundur të ngrihen sektionet e posaçme, drejtuesi i prokurorisë përkatëse cakton një prokuror për të ndjekur grupveprat penale kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, kimeve financiare dhe hetimeve pasurore.

3. Përzgjedha dhe caktimi i prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore sipas këtij nenit, bazohet në kriteret profesionale, si vijojnë:

a) të kenë eksperiencë në punë jo më pak se 4 vjet;

b) të kenë marrë pjesë në trajnime për veprat penale në kompetencë lëndore të sektionit e posaçëm;

c) të kenë eksperienca dhe rezultate në çështje konkrete në kompetencë lëndore:

i) në kryerjen e hetimeve, për oficerët e policisë gjyqësore dhe;

ii) në ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjykatë, për prokurorët;

Në prokuroritë ku nuk mund të plotësohet kriteri i shkronjës “a”, përzgjidhet dhe caktohet prokurori që ka eksperiencë me kohëzgjatje më të madhe në punë dhe që plotëson kriteret e tjera të pikës 3 të këtij nenit.

4. Krijimi i sektioneve të posaçme dhe caktimi i prokurorëve kryhet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.

Neni 5

#### **Caktimi i pikave të kontaktit dhe roli i tyre**

1. Në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridikcion të përgjithshëm caktohen pikat e kontaktit për koordinimin, monitorimin dhe shkëmbimin e informacionit në zbatim të këtij udhëzimi të përgjithshëm.

2. Në Prokurorinë e Përgjithshme pikë kontakti është prokurori/shef i Sektorit të Monitorimit pranë Drejtorisë së Koordinimit Institucional.

3. Në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, ku krijohen sektionet e posaçme, pikë kontakti është shefi i sektionit e posaçëm.

4. Në prokuroritë ku nuk mund të ngrihen seksione të posaçme pikë kontakti është drejtuesi i prokurorisë përkatëse, ose zëvendës drejtuesi i autorizuar prej tij ose prokurori i caktuar sipas nenit 4 pika 2 e këtij udhëzimi.

5. Prokurori pikë kontakti, i ndihmuar nga oficeri i policisë gjyqësore i caktuar pranë tij dhe/ose nëpunësi i administratës, për rastet e trajtuar lidhur me procedimet penale dhe hetimet pasurore në kompetencë lëndore sipas këtij udhëzimi, mban të dhënat në një regjistër të veçantë të gjurmimit të rasteve (track record) sipas formatit Lidhja 2 bashkëlidhur.

a) Në këtë rregjistër shënohen të dhëna mbi, -referuesin e materialit të kallëzuar sipas tipologjive, -vepra/at penale bazë dhe të tjera (pastrimi i parave ose financimi i terrorizmit), -hetimet paralele për pastrim të parave ose financim terroristi, -hetimet paralele finaciare ose pasurore, -kërkosat për jashtë vendit dhe ato të ardhura nga autoritetet gjyqësore të huaja për këto vepra penale sipas tipologjive, dhe jo vetëm, (-me një vepër bazë/kallëzim të huaj, -pastrimi i parave të palëve të treta nga profesionistë dhe pastrimi i parave i pavarur nga ndonjë vepër kryesore/bazë mbështetur në prova rrethanore), -masat e sigurimit personal, dhe/ose -masat e sigurimit pasuror sipas llojeve (sende ose vlera monetare, etj) pas shpalljes së tyre me vendim gjyqësor dhe ekzekutimit të tyre, -përdorimin e metodave speciale të hetimit pas përfundimit të hetimeve, -numrin e subjekteve të dyshuar për kryerjen e veprës penale (person, person fizik dhe/ose person juridik), -ecuria dhe mënyra e përfundimit të procedimit në fazën e hetimeve paraprake, -kërkosat e prokurorit në gjykatë, përfshi dhe kërkosat për konfiskim të pasurisë të sekuestruar, sipas tipologjive të rekomanduara, dhe jo vetëm, (nga -palët e treta të pastrimit të parave me subjekte të posaçëm/profesionist, nga -vetë subjektet raportuese (gatekeeper) si dhe asetat që përfaqësojnë të -ardhura indirekte nga vepimtaria kriminale dhe/ose -me vlerë ekuivalente me të ardhurat nga vepimtaria kriminale), -vendimet e gjykatës sipas shkallëve të gjykimit si dhe -të dhëna të tjera sipas këtij regjistri.

b) Në regjistrin e gjurmimit të rasteve (track record), përditësohet ecuria për secilin kallëzim dhe/ose çështje penale dhe/ose hetim pasuror, sipas tipologjive në shkronjën "a" të pikës 5 të këtij neni, për hetimin dhe ndjekjes penale fazave.

## Neni 6

### **Informimi, koordinimi dhe monitorimi**

1. Prokurori i caktuar, në zbatim të rekomandimeve të KSA-së e FATF-së dhe Planit të Veprimit të ICRG/FATF, dhe jo vetëm, si pikë kontakti përditëson dhe raporton, si të dhënat statistikore çdo datë 10 të muajit përkatës, ose sa herë që kërkohet, ashtu dhe track record sipas tabelës përkatëse, çdo ditë të premte brenda orarit zyrtar, për referime/kallëzime dhe/ose çështje që është aktualisht në hetim, pavarësisht vitit si dhe çdo referim/kallëzim, sipas tipologjive, të ardhur nga data e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi<sup>26</sup>.

2. Prokurori i caktuar, si pikë kontakti në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, administron edhe aktet/vendimet përkatëse si mosfillim procedimi, kërkosë për pushim

<sup>26</sup> Raportimi duhet të përbajë të dhëna statistikore si dhe shembuj, duke evidentuar sistematicitetin e qasjes së kërkuar. Përfshirja në çdo plan hetimi e detyra për hetimin financier paralel, gjatë dhe/ose jashtë hetimit penal. Rritje të hetimeve proaktive me indicie Policore dhe/ose rritje të përdorimit të metodave speciale të hetimit).

çështje/akuze apo kërkesë për dërgim çështje për gjykim, etj, si dhe vendim përfundimtar të gjykatës përkatëse, dhe ia dërgon pikës së kontaktit në Prokurorinë e Përgjithshme, i cili i dërgon tek Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave.

3. Informimi dhe dërgimi i akteve do të bëhet, drejtpërdrejtë me email nga prokurori i caktuar si pikë kontakti tek prokurori/ Shef i Sektorit të Monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme, dhe zyrtarisht nëpërmjet Drejtuesit të Prokurorisë në Drejtorenë Koordinimit Institucional në Prokurorinë e Përgjithshme.

Neni 7

### **Forcimi i kapaciteteve profesionale**

1. Prokurorët pranë sektionit të posaçëm dhe prokurorët e caktuar për të ndjekur grupveprat penale sipas kompetencës lëndore të sektionit të posaçëm në prokuroritë që nuk është e mundur ngritja e tyre, në kuadrin e trajnimit vazhdues, sipas nevojës mund të planifikojnë me përparësi trajnime me tema në fushën e pastrimit parave, kimeve financiare, financimin e terrorizmit dhe hetimeve pasurore, për forcimin e kapaciteteve profesionale të tyre.

2. Në kuadrin e trajnimeve të përbashkëta, këto prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore që ushtrojnë funksionet pranë tyre përfshihen në aktivitetet trajnuese me officerë të policisë gjyqësore të strukturave përkatëse hetimore në policinë e shtetit, dogana, tatime, dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese, dhe jo vetëm, në zbatim të Memorandumit të Bashkëpunimit, me tema lidhur me analizën e riskut, gjurmimin, verifikimin, hetimin, ndjekjen penale dhe gjykin e veprave penale të pastrimit të parave, krimet financiare, financimit të terrorizmit dhe hetimet pasurore, me synim forcimin e kapaciteteve profesionale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, kimeve financiare, financimin e terrorizmit dhe sekuestrimin e konfiskimin e aseteve dhe të ardhurave kriminale.

Neni 8

### **Shkëmbimi i informacionit ndërinstитucional**

1. Prokurorët e sektionit të posaçëm dhe prokurori i caktuar sipas pikës 2 të nenit 4 të këtij udhëzimi, bashkëpunojnë, kryejnë analiza të përbashkëta dhe shkëmbenjë informacione, me strukturat e posaçme hetimore në, drejtorenë e policisë vendore dhe/ose të komisariateve të policisë, tatime dhe dogana, për zbatimin e rekomandimeve të KSA-së e FATF-së dhe Planit të Veprimit të ICRG/FATF si dhe Memorandumit të Bashkëpunimit.

2. Pika e kontaktit në prokurori bashkërendon me pikat e kontaktit të strukturave përkatëse në nivel vendor, në takimet e përbashkëta që organizojnë çdo javë, dhe/ose sipas nevojave të ngutshme kur kërkohet nga secila pikë kontakti, për të shqyrtau ecuinë e treguesve për çështjet në ndjekje, problematikat e evidentuara, planifikimin e eurisë së masave vijuese dhe shkëmbimin e informacionit.

## MASAT PROCEDURALE PENALE

### SEKSIONI PARË

#### KOMPETENCA DHE REGULLIME TË PËRGJITHSHME

Neni 9

##### **Kompetenca lëndore**

1. Prokurorët në seksionin e posaçëm dhe prokurorët e caktuar në prokuroritë ku nuk mund të ngrihen seksione (neni 4 pika 2 i këtij udhëzimi), ushtrojnë funksionet:

a) kryejnë hetime dhe ushtrojnë ndjekje penale për veprat penale të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare, të listuara në shkronjat “a” deri “e”, pika 1, e nenit 3 të këtij udhëzimi.

b) kryejnë hetime financiare ose hetime pasurore që lidhen me procedimet penale që kanë në ndjekje, sipas parashikimeve në pikat 4 e 5 të nenit 3 të këtij udhëzimi.

c) kryejnë hetime pasurore në bazë të ligjit nr.10192/2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korruptionit dhe krimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”, i ndryshuar, për rastet e referuara/kallëzuara nga policia gjyqësore, organe/agjenci ligjzbatusse, dërguar për kompetencë lëndore ose nga autoritete gjyqësore të huaja.

3. Prokurorët e tjerë në prokuroritë përkatëse me juridiktion të përgjithshëm, në rastet, sipas parashikimit në shkronjën “e”, pika 1 e nenit 3 të këtij udhëzimi, kur kryerja e veprës penale në kompetencë lëndore të tyre ka sjellë pasuri/asete që janë produkt i veprës penale, ushtrojnë funksionet:

a) kryejnë hetime dhe ushtrojnë ndjekje penale edhe për veprën penale, pastrimi i parave ose financimi i terrorizmit, lidhur me pasuritë/asetet produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale, sipas tipologjive në shkronjën “a”, pika 1 e nenit 3 të këtij udhëzimi.

b) kryejnë hetime financiare ose hetime pasurore që lidhen me procedimin penal që kanë në ndjekje, sipas përcaktimeve në shkronjën “b”, pika 1 e këtij nenit.

4. Në prokuroritë ku janë ngritur dhe funksionojnë seksionet e posaçme, në rastet e parashikuara nga shkronja “a” e “b” të pikës 3 të këtij nenit, prokurori që ndjek çështjen/procedimin në bashkërendim me drejtuesin e prokurorisë dhe shefin e seksionit të posaçëm, vlerësojnë dhe dakortësohen, nëse çështja/aktet do të vijojnë të ndiqen nga prokurori i çështjes apo do t'i kalojë për ndjekje të mëtejshme seksionit të posaçëm.

Neni 10

##### **Bashkërendimi dhe koordinimi në ushtrimin e funksioneve**

1. Prokurorët e seksionit të posaçëm dhe prokurorët e caktuar në prokuroritë ku nuk mund të ngrihen seksione (neni 4 pika 2 i këtij udhëzimi) në ushtrimin e funksioneve bashkërendojnë me oficerët e policisë gjyqësore të sektioneve dhe të shërbimeve në

strukturat hetimore përkatëse në policinë e shtetit, dogana, tatime, DPPP dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese për koordinimin e veprimtarisë ndërmjet tyre:

a) në fazën e gjurmimit të veprave penale, objekt i këtij udhëzimi nëpërmjet një konsultimi dhe koordinimi për kërkimin dhe vlerësimin e informacioneve dhe/ose indicieve për kryerjen e hetimeve proaktive dhe përdorimin e mjeteve të posaçme të hetimit;

b) në fazën para referimit/kallëzimit nëpërmjet një konsultimi e vlerësimi paraprak të materialeve objekt referimi apo kallëzimi penal lidhur me plotshmërinë e akteve/dokumentave që qartësojnë rrëthanat e faktit dhe ekzistencën e elementeve të figurës së veprës penale përkatëse;

c) në fazën e kryerjes së hetimeve dhe ushtrimit të ndjekjes penale nëpërmjet kryerjes së analizave të përbashkëta për kërkimin, gjetjen dhe administrimin e provave gjatë veprimtarisë hetimore dhe në fazat e ushtrimit të ndjekjes penale, për vijimin e administrimit dhe dërgimit në prokurori të provave dhe/ose indicieve të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën nga strukturat hetimore të shërbimeve të policisë gjyqësore përkatëse apo agjencitë ligjzbatuese të tjera.

2. Ushtrimi i kësaj veprimtarie bashkërenduese e koordinuese kryhet pa u cënuar pavarësia e prokurorëve të seksionit të posaçëm apo prokurorëve të përfshirë, në ushtrimin e funksioneve të tyre sipas kushtetutës dhe ligjit.

Neni 11

### **Kujdesi për mbarëvajtjen e ecurisë së çështjes**

1.Drejtuesi i prokurorisë<sup>27</sup> për prokurorët e seksionit të posaçëm dhe/ose për prokurorët e tjerë të përfshirë që drejton ose drejtuesi i seksionit të posaçëm<sup>28</sup> për prokurorët e seksionit që drejton, në momentin e caktimit të procedimit/çështjes për vlerësim/ndjekje prokurorit përkatës, për veprat penale sipas kompetencës lëndore që parashikon neni 9 i këtij udhëzimi, kur e vlerësojnë të nevojshme për mbarëvajtjen e ecurisë së procedimit/çështjes, nxjerrin udhëzime jo të detyrueshme me shkrim<sup>29</sup> për prokurorin përkatës, ku veç të tjerave mund të udhëzojnë:

- a) për të kërkuar konsultë teknike me ekspertët e shërbimit të ekspertizës;
- b) për të bashkërenduar dhe koordinuar me strukturat hetimore përkatëse apo agjencitë ligjzbatuese;
- c) për të qartësuar mekanizmin e kryerjes së veprës penale të referuar/kallëzuar dhe për të paracaktuar tipologjinë dhe veçoritë e hetimit;
- ç) për administrimin e provave të nevojshme, mënyrën e kërkimit dhe vendndodhjen e mundshme për gjetjen dhe/ose zbulimin e tyre;
- d) caktimin e vlerës së përafërt të pasurisë së sekuestruar që duhet të administrohet në hetim;
- dh) për kërkime teknike të nevojshme për të siguruar informacione, indicie apo prova shtesë për procedimin penal si dhe;

<sup>27</sup> Shih, nenin 48 “Udhëzimet jo të detyrueshme për çështje konkrete”, pika 1 shkronja “c”.

<sup>28</sup> Shih, nenin 48, pika 1 shkronja “2”.

<sup>29</sup> Shih, nenin 48, pika3 e 4.

e) për kryerjen e detyrave specifike për të garantuar një hetim të plotë e të gjithanshëm në kuadrin e një procedimi të drejtë dhe të rregullt ligjor.

## **SEKSIONI DYTË**

### **HETIMET PARALELE**

Neni 12

#### **Hetime paralele në ushtrimin e ndjekjes penale**

1. Prokurorët në seksionin e posaçëm ose prokurorët e caktuar në prokuroritë ku nuk mund të ngrihen seksione në ushtrimin e ndjekjes penale për veprat penale të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare, të listura në shkronjat “a” deri “e”, pika 6, e nenit 3 të këtij udhëzimi, duhet të tregojnë vemendje të veçantë në rastet dhe jo vetëm, sipas tipologjive, -pastrimi i parave me një vepër bazë/kallëzim të huaj, -pastrimi i parave nga palë të treta profesioniste dhe pastrimi i parave i pavarur nga ndonjë vepër kryesore/bazë mbështetur në rrrethana fakti objektive (prova rrrethanore).

2. Prokurorët në rastet kur kryerja e veprës penale në kompetencë lëndore të tyre, (sipas neni 3 pika 1 shkronjat “b”-“d” të këtij udhëzimi), ka sjellë pasuri/asete që janë produkt i veprës penale, krahas ndjekjes penale për veprën penale kryesore, kryejnë hetime paralele edhe për veprën penale sipas rastit, pastrimi i parave ose financimi i terrorizmit për pasuritë/asetet produkt i veprës penale ndaj subjekteve përkatës sipas parashikimit në pikën 1 të këtij neni.

Neni 13

#### **Hetimi finanziar**

1. Në të gjitha procedimet penale të regjistruara prokurorët e seksionit vlerësojnë kryerjen e hetimeve (paralele) financiare me qëllim sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të veprës penale sipas parashikimeve të nenit 36 të Kodit Penal.

2. Në funksion të këtyre hetimeve prokurorët vlerësojnë përdorimin e të gjitha mjeteve të kërkimit të provës sipas Kodit të Procedurës Penale për identifikimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të veprës penale.

3. Rezultatet e hetimit finanziar integrohen me ato të hetimit pasuror.

4. Në çdo rast të kryerjes së hetimeve financiare, prokurori kur vlerëson se ekzistojnë kushtet dhe kriteret ligjore<sup>30</sup> i kërkon gjykatës sekuestro preventive të produkteve të veprës penale dhe/ose çdo lloj pasurie tjeter që ligji penal<sup>31</sup> lejon të konfiskohet. Në këtë raste, dhe jo vetëm, duhet të tregohet vemendje e veçantë, për tipologjitet: -pasuri/asete të palëve të treta, -të subjekteve të posaçëm/profesionist; -të vetë subjekteve raportuese (gatekeeper) si dhe -aseteve që përfaqësojnë të ardhura indirekte, dhe/ose -vlerë ekuivalente.

5. Në përfundim të gjykimit të çështjeve penale për vepra penale prej të cilave është përfstuar pasuri/asete produkte të veprës penale të sekuestruara ose të pa sekuestruara,

---

<sup>30</sup> Shih, nenin 274 e vijues të K.Pr.Penale.

<sup>31</sup> Shih, nenin 36 të K.Penal.

prokurori kur vlerëson se ekzistojnë kushtet/kriteret ligjore, në konkluzionet përfundimtare i kërkon gjykatës konfiskimin e produkteve të veprës penale dhe/ose të çdo pasurie, vlera e së cilës i korrespondon asaj të produkteve të veprës penale sipas përcaktimeve të nenit 36 të Kodit Penal.

Neni 14

### **Hetimi pasuror**

1. Policia gjyqësore e shërbimeve në strukturat hetimore të posaçme në Policinë e Shtetit me marrjen dijeni për masa parandaluese kundër pasurisë sipas ligjit<sup>32</sup>, me iniciativën e vet ose me njoftimin e bërë nga organe/agjenci të tjera të zbatimit të ligjit ose me njoftimet e autoriteve policore apo gjyqësore të huaja, kryen pa vonesë verifikimet paraprake për personat dhe pasuritë që sipas ligjit duhen verifikuar<sup>33</sup>, me anë të cilëve administron të dhëna, indicie dhe/ose akte/dokumenta<sup>34</sup> që evidentojnë elementet thelbësore të faktit për zbatimin e këtij ligji<sup>35</sup>.

2. Drejtorinë e Marrëdhënieve JuridikSIONALE me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme, me marrjen e letërporosive/kërkesave të autoriteteve gjyqësore të huaja, për masa parandaluese kundër pasurisë dhe/ose për njohje të vendimit penal të huaj apo ekstradim sipas parashikimit në ligj<sup>36</sup>, kur vlerëson të nevojshme kryerjen e verifikimeve paraprake, menjëherë bashkërendon dhe ia dërgon policisë gjyqësore të shërbimeve në strukturat hetimore të posaçme në Policinë e Shtetit për kryerjen pa vonesë të verifikimeve paraprake për personat dhe pasuritë që duhen verifikuar sipas normimit në pikën 1 të këtij neni.

3. Oficeri i policisë gjyqësore i shërbimeve në strukturat hetimore të posaçme në Policinë e Shtetit, brenda tre muajve nga marrja dijeni, përfundon verifikimin paraprak për masat parandaluese kundër pasurisë sipas pikës 1 e 2 të këtij neni, dhe pas konsultimit/vlerësimit paraprak të materialit me prokurorin (e seksionit të posaçëm ose prokurorin e çaktuar në prokuroritë ku nuk mund të ngrihen seksione), referon në prokurori materialin me verifikimet paraprake të kryera për personat dhe pasuritë, që përmban të dhëna, indicie dhe aktete/dokumenta që evidentojnë elementet thelbësore të faktit për zbatimin e këtij ligji ose mungesën e pasurive të rezultuar nga verifikimi paraprak.

4. Prokurori, brenda 15 ditëve nga mbërritja/regjistrimi i materialit të verifikimit paraprak të policisë gjyqësore, bazuar në aktet e referuara, verifikon dhe vlerëson

<sup>32</sup> Shih, nenet 3 “Fusha e veprimit” dhe 7 Kompetenca...” te ligjit nr.10192/2009 i ndryshuar.

<sup>33</sup> Shih, nenin 8 në lidhje me nenin 3 e vijues të ligjit nr.10192/2009 i ndryshuar

<sup>34</sup> Shih, veprimet për personat dhe pasuritë që duhen verifikuar, siç mund të janë:

“a) Kërkim informacioni nëse personi i dyshuar ka qenë i përfshirë në veprimitari kriminale brenda vendit.  
b) Identifikimi i një lidhje midis të dyshuarit dhe aktiviteteve kriminale, apo çdo lloj lidhje që ai mund të ketë me njëherë apo grupe të përfshirë në veprimitari kriminale;  
c) Rritja e pazakonshme e aseteve ose transfertave të parave në një formë që evidenton operacione që nuk janë në përputhje me praktikat normale të biznesit;  
d) Mungesa e aktiviteteve ligjore të biznesit që justifikojnë rritjen e aseteve ose transfertat e parave;

d) Statusi i pronave të luajtshme dhe të paluajtshme;  
dh) Kryerja e verifikime në vendndodhjen e pasurisë/objektit dhe gjetjet pasqyrohen në procesverbalin përkatës të shoqëruar me fotot përkatëse”

<sup>35</sup> Shih, nenin 3 e vijues të ligjit nr.10192/2009 i ndryshuar.

<sup>36</sup> Shih, nenin 3 “Fusha e veprimit” ligji nr.10192/2009 i ndryshuar.

ekzistencën e elementeve thelbësore të faktit dhe kushteve e kritereve ligjore sipas përcaktimit në nenin 3 të ligjit<sup>37</sup>, dhe vendos:

a) Në rastet kur me gjendjen e akteve të referuara dhe verifikuara paraprakisht nga policia gjyqësore e strukturës hetimore të posaçme në Policinë e Shtetit ose edhe vetë prej tij nëse ka nevojë për një gjë të tillë, prokurori vlerëson se nuk ka të dhëna, indicie dhe akte/dokumenta që evidentojnë elemente thelbësore të faktit për zbatimin e këtij ligji ose nuk ka pasuri për të cilat mund të kërkohet aplikimi i masave parandaluese pasurore, vendos mosfillimin e hetimit pasuror<sup>38</sup>.

b) Në rastet kur materiali i referuar nga policia gjyqësore e strukturës hetimore të posaçme në Policinë e Shtetit shoqërohet me të dhënat, indicet dhe aktet/dokumentat për personat dhe pasuritë që evidentojnë elementet thelbësore të faktit për zbatimin e këtij ligji ose ka pasuri për të cilat mund të kërkohet aplikimi i masave parandaluese pasurore, prokurori urdhëron, regjistrimin<sup>39</sup> e hetimit pasuror<sup>40</sup>, dhe/ose nga moment në të cilin rezulton regjistrimin e emrit të personit që zotëron pasuritë<sup>41</sup>, sipas nenit 3 të këtij ligji.

c) Me regjistrimin e hetimit pasuror të gjitha verifikimet pasurore konsiderohen hetime pasurore.

5. Prokurori në rastet kur regjistron hetimin pasuror<sup>42</sup>, kryen vetë dhe/ose nëpërmjet oficerëve të polisë gjyqësore, (të strukturës hetimore të posaçme në Policinë e Shtetit ose të sektionit në prokurori), veprime të vazhdueshme (shmang zvarritjet e pajustifikueshme) për hetimin e mjeteve financiare, pasurive, veprimtarive ekonomike, tregtare dhe profesionale, nivelin ekonomik, mënyrën e jetesës si dhe burimin e të ardhurave të personave, objekt hetimi, në afatet e përcaktuara sipas këtij ligji<sup>43</sup> dhe rregullave të parashikuara në K.Pr.Penale<sup>44</sup>, si më poshtë:

a) Hetimet pasurore duhet përfundojnë brenda afatit<sup>45</sup> të parashikuar në Kodin e Procedurës Penale për veprën penale që është regjistruar hetimi pasuror, me përjashtim të

<sup>37</sup> Shih, po aty nenin 3, pika 1 e 2.

<sup>38</sup> Shih nenin 5 “Marrëdhëni me procedimin penal” pika 2 të ligjit nr.10192/2009 i ndryshuar, në lidhje me nenin 291 të K.Pr.Penale, që parashikojnë:

-Pika 2 e nenit 5 të ligjit nr. 10192/2009 i ndryshuar parashikon: “2. Verifikimi, hetimi dhe gjykimi, sipas këtij ligji, mbështeten në rregullat procedurale të këtij ligji dhe plotësohen nga rregulla të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale, sipas rastit. Të dhënat e marra nga procesi penal përdoren në procedurën e parashikuar nga ky ligji.”

-Pika 1 e nenit 291 “Vendimi për mosfillimin e procedimit” të K.Pr.Penale, parashikon: “1. Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit brenda 15 ditëve nga regjistrimi i kallëzimit.”

<sup>39</sup> Shih, formatin e përditësuar të regjistrat të miratuar me Urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm nr.165 datë 24.07.2017, bashkëlidhur.

<sup>40</sup> Shih nenin 5 “Marrëdhëni me procedimin penal” pika 2 të ligjit nr.10192/2009 i ndryshuar, në lidhje me nenin 287 të K.Pr.Penale, që parashikojnë:

-Pika 1 e nenit 287 “Regjistrimi i njoftimit të veprës penale” të K.Pr.Penale, parashikon: “1. Prokurori shënon në regjistër çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet dhe në të njëjtën kohë ose nga momenti në të cilin rezulton, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale.”

<sup>41</sup> Shih nenin 3 pika 1 e 2 të ligjit nr.10192/2009 i ndryshuar.

<sup>42</sup> Shih, formatin e përditësuar të regjistrat të miratuar me Urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm nr.165 datë 24.07.2017, bashkëlidhur.

<sup>43</sup> Shih nenin 5 “Marrëdhëni me procedimin penal” pika 2 të ligjit nr.10192/2009 i ndryshuar.

<sup>44</sup> Shih nenet 323, 324, 325 të K.Pr.Penale.

<sup>45</sup> Shih nenin 5 “Marrëdhëni me procedimin penal” pika 2 të ligjit nr.10192/2009 i ndryshuar, në lidhje me nenet 323, 324pika 1 e 2 të K.Pr.Penale.

-Pika 1 e nenit 287 “Regjistrimi i njoftimit të veprës penale” të K.Pr.Penale, parashikon: “1. Prokurori shënon në regjistër çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet dhe në të njëjtën kohë ose nga momenti në të cilin rezulton, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale.”

rasteve kur kompleksiteti i hetimeve nuk e lejon. Në këto raste prokurori duhet të informojë drejtuesin për shkaqet e mospërfundimit në kohë të hetimit pasuror.

b) Pas përfundimit të afatit maksimal, hetimet pasurore mund të vazhdojnë për aq sa do të jetë kohëzgjatja e sekuestros.

c) Rregullshmëria dhe vijueshmëria e kryerjes së veprimeve në kuadër të hetimit pasuror verifikohet nga drejtuesi i prokurorisë mbi bazën e kërkesës për informacion që i drejton prokurorit.

ç) Prokurori që vazhdon hetimin pasuror duhet t'i përfundojë ato brenda një afati të arsyeshëm.

6. Në rastet kur gjatë kryerjes së hetimeve pasurore apo në përfundim të tyre rezultojnë pasuri për të cilat kërkohet aplikimi i masave pasurore parandaluese sipas ligjit, prokurori vlerëson kushtet dhe kriteret ligjore për sekuestrimin e pasurisë dhe me kërkesë të arsyetuar i kërkon gjykatës sekuestrimin e pasurive, të ardhura në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në pronësi të plotë ose të pjesëshme të personave/subjekteve sipas ligji<sup>46</sup> ose sekuestrimin e pasurive të barazvlefshme<sup>47</sup>.

7. Policia gjyqësore, pasi kryen veprimet hetimore pasurore të nevojshme, pas konsultimit/vlerësimit paraprak me prokurorin ia dërgon aktet bashkë me një relacion shpjegues për rr Ethanat e faktit dhe provat/dokumentat si dhe me sugjerimet për masat parandaluese kundër pasurisë.

8. Në përfundim të hetimit pasuror prokurori vlerëson dhe vendos:

a) Kërkimin në gjykatë të konfiskimit të pasurisë kur vlerëson se plotësohen kushtet dhe kriteret ligjore<sup>48</sup> për konfiskimin e pasurisë së sekuestruar ose konfiskimin e pasurive të pa sekuestruara, sipas parashikimeve në ligj<sup>49</sup>, duke kryer çdo veprim hetimor të nevojshëm deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të kërkesës për konfiskim.

b) Pushimin e hetimit pasuror në rastet kur:

i) nuk rezultojnë pasuri ndaj të cilave mund të aplikohen masat ndaj pasurisë që parashikon ligj;

ii) me gjendjen e akteve të administruara në përfundim të hetimit pasuror vlerëson se nuk ka indicie dhe/ose akte/dokumenta që evidentojnë kushtet dhe kriteret për të kërkuar konfiskimin e pasurisë;

iii) kërkesa e prokurorit për konfiskim ose kërkesa e prokurorit për sekuestrim nuk pranohet nga gjykata sipas parashikimeve në ligj<sup>50</sup>.

9. Në rastet kur prokurori vlerëson se, krahas kërkesës për konfiskim, duhet të vazhdojë kryerja e hetimeve pasurore për pasuri të tjera që mund të ketë subjekti, vendos vecimin e akteve të hetimit pasuror nga ato që i dërgohen gjykatës për gjykim pasuror. Afatet për këtë hetim pasuror llogariten që nga regjistrimi i hetimit pasuror bazë.

10. Në rastet kur pas vendimit të mosfillimit të hetimit pasuror ose pas vendimit të pushimit të hetimit pasuror dalin ose zbulohen të dhëna ose prova të reja, të cilat tregojnë se vendimi i mosfillimit ose vendimi i pushimit nuk është i bazuar, prokurori kryesisht ose me kërkesë të viktimës apo trashëgimtarëve të saj sipas rastit vendos:

<sup>46</sup> Shih, nenin 11 e vijues të ligjit nr.10192/2009 i ndryshuar.

<sup>47</sup> Shih, po aty nenin 12/a në lidhje me nenin 11 e vijues të ligjit nr.10192/2009 i ndryshuar.

<sup>48</sup> Shih, po aty nenet 24 “Pranimi I kërkesës për konfiskim” i ligjit nr.10192/2009 të ndryshuar.

<sup>49</sup> Shih, nenet 21, 22 e vijues të ligjit nr.10192/2009 i ndryshuar.

<sup>50</sup> Shih, nenin 24/a dhe nenin 12 në lidhje me nenin 13 të ligjit nr.10192/2009 i ndryshuar.

- a) Revokimin e vendimit të mosfillimit dhe kryerjen e verifikimeve paraprake ose regjistrimin e hetimit pasuror;
- b) Revokimin e vendimit të pushimit dhe rifillimin e hetimit pasuror.

Neni 15

### **Ruajtja e sekretit hetimor, ndalimi i publikimit të akteve dhe mbrojtja e të dhënavë personale**

1. Në zbatim të këtij udhëzimi prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore të seksionit dhe të shërbimeve të policisë gjyqësore në strukturat hetimore përkatëse dhe/ose në agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit, ekspertët e shërbimit të ekspertizës dhe drejtuesit e prokurorive dhe të seksioneve në prokuroritë me juridikcion të përgjithshëm marrin të gjitha masat për ndalimin e publikimit të akteve<sup>51</sup>, për ruajtjen e sekretit hetimor<sup>52</sup>, dhe mbrojtjen e të dhënavë personale<sup>53</sup>, duke respektuar detyrimet ligjore, si më poshtë:

a) Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve sekrete që lidhen me çështjen ose dhe vetëm i përbajtjes së tyre nëpërmjet shtypit ose informacionit masiv. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm i akteve jousekrete deri në përfundimin e hetimeve paraprake. 3. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm i akteve të shqyrtimit gjyqësor kur gjykimi bëhet me dyer të myllura. Ndalohet publikimi i gjeneraliteteve dhe i fotografive të të pandehurve dhe të dëshmitarëve të mitur të akuzuar ose të dëmtuar nga vepra penale.

b) Aktet hetimore janë sekret derisa i pandehuri të mos ketë marrë dijeni për to. Në rast nevoje për vazhdimin e hetimeve prokurori mund të urdhërojë ruajtjen e sekretit dhe ndalimin e publikimit për akte të veçanta deri në përfundim të hetimeve. Urdhri shoqërohet me përpilimin dhe nënshkrimin e deklaratës për ruajtjen e sekretit hetimor dhe ndalimin e publikimit.

### **KREU IV**

### **PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE, ZBATIMI, DISPOZITA KALIMTARE, SHFUQIZIME, HYRJA NË FUQI DHE PUBLIKIMI**

Neni 16

#### **Shkeljet dhe përgjegjësia disiplinore**

Shkelja e dispozitave ligjore referuese në këtë udhëzim të përgjithshëm dhe/ose moszbatimi i detyrimeve të përcaktuara në këtë udhëzim, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë shkelje disiplinore sipas ligjit<sup>54</sup> dhe shkak për të kërkuar fillimin e inspektimit dhe/ose hetimit disiplinor ndaj prokurorit dhe/ose drejtuesit përkatës të prokurorisë me juridikcion të përgjithshëm.

<sup>51</sup> Shih, po aty nenet 103, 104, 105/5.

<sup>52</sup> Shih, nenin 279 të K.Pr.Penale, i ndryshuar.

<sup>53</sup> Shih, nenet 2, 4, 6 pika 2, 18 pika 3 shkronja "b", 21 pika 3, 28 e vijues të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënavë personale", i ndryshuar.

<sup>54</sup> Shih, nenin 101 pika 1 shkronja "a", "b" dhe nenin 102 pika 1 shkronjat "ç", "d", "ë", "g" "j", "l" "ll" dhe pika 2 shkronjat "a", "b", "c", "ç", "d" "dh" e vijues të ligjit nr.96/2016 i ndryshuar me ligjin nr. 48/2019.

## Neni 17

### Zbatimi dhe mbikëqyrja

1. Ky udhëzim i përgjithshëm është i detyrueshëm për zbatim nga prokurorët e sektionit të posaçëm, prokurorët e caktuar në ato prokurori ku nuk mund të ngrihen seksione të posaçne, prokurorët e tjerë dhe drejtuesit e prokurorive me juridikSION të përgjithshëm dhe oficerët e policisë gjyqësore në strukturat hetimore të shërbimeve përkatëse dhe të seksioneve pranë prokurorive me juridikSION të përgjithshëm<sup>55</sup>.

2. Me mbikëqyrjen e zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen drejtuesit e prokurorive dhe drejtuesit e seksioneve të posaçëm në prokuroritë me juridikSION të përgjithshëm<sup>56</sup>, dhe Shefi i Sektorit të Monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët për ecurinë e zbatimit të këtij udhëzimi informjnë Prokurorin e Përgjithshëm.

3. Drejtuesit e prokurorive mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme për lehtësimin e zbatimit të këtij udhëzimi të përgjithshëm<sup>57</sup>.

## Neni 18

### Dispozita kalimtare

1. Të gjitha masat e parashikuara në nenin 14 “Hetimet pasurore” zbatohen sipas mënyrës së hyrjes në fuqi që parashikon nenin 20 i këtij udhëzimi.

2. Për hetimet pasurore sipas ligjit nr.10192/2019, të mbartura nga viti 2019 ose të regjistruala në vitin 2020, ky udhëzim i përgjithshëm fillon të zbatohet me 1 shtator 2020.

3. Materialet e referuara në prokurori dhe/ose hetimet pasurore që janë në fazën e hetimit do të vazhdojnë të ndiqen në çdo fazë të hetimit ose të gjykimit nga prokurori që i kishte në ndjekje para datës së hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi të përgjithshëm.

4. Ditën e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, në Regjistrin e Hetimeve Pasurore, Lidhja 3, bashkëlidhur, fillimi shtë regjistrohen (me statusin të mbartura) referimet/kallëzimet dhe/ose procedimet/hetimet pasurore të regjistruala deri një ditë para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, duke i numërtuar sipas numrit rendor kronologjik të regjistrat të ri dhe me fraksion numri/data e regjistrimit sipas regjistrat nga janë mbartur.

5. Në urdhrin nr.165, datë 24.07.2017, “Për regjistrat dhe administrimin e tyre në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridikSION të përgjithshëm” ndryshohen shkronjat “e” dhe “f” të pikës 1 të nenit 2, si më poshtë:

a) “Regjistri i masave të sigurimit pasuror”, modeli 7 ndryshohet në “Regjistri i Hetimit Financiar” modeli 7, Lidhja 2, bashkëlidhur;

b) “Regjistri i hetimit pasuror” modeli 9, ndryshohet në “Regjistri i Hetimit Pasuror” modeli 9, Lidhja 3, bashkëlidhur.

5.1 Modelet e regjistrave statistikorë të udhëzimit të përgjithshëm nr.06, datë 20.11.2018 “Për hetimin pasuror, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të veprës penale”, sic janë: modeli “Statistika për Hetimin Financiar” i ndryshuar, Lidhja 4

<sup>55</sup> Shih nenin 46 pika 1 dhe nenin 67 të ligjit nr.97/2016

<sup>56</sup> Shih po aty nenin 43 shkronja “dh”.

<sup>57</sup> Shih po aty nenet 46 pika 4.

bashkëlidhur, dhe modeli “Statistika për Hetimin Pasuror” i ndryshuar, Lidhja 5 bashkëlidhur, janë pjesë e këtij udhëzimi.

5.2 Zyra e regjistrat mban dhe raporton periodikisht, ose sa herë që kërkohet, në Prokurorinë e Përgjithshme të dhënat statistikore sipas formave Lidhja 4 dhe Lidhja 5 bashkëlidhur.

6. “Manuali i Projektit të Binjakëzimit i BE-së “Mbështetje për strukturat e luftës kundër pastrimit të parave dhe strukturat e krimeve financiare në Shqipëri” në Lidhja 6, bashkëlidhur, është i zbatueshëm deri me administrimin zyrtarisht të “Manualit të përditësuar të Projektit të Binjakëzimit të BE “Mbështetje për strukturat e luftës kundër pastrimit të parave dhe strukturat e hetimit të krimeve financiare në Shqipëri”.

Neni 19

### **Shfuqizime**

Udhëzimi i përgjithshëm nr.06, datë 20.11.2018 “Për hetimin pasuror, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të veprës penale”, shfuqizohet.

Neni 20

### **Hyrja në fuqi dhe publikimi**

1. Ky udhëzim i përgjithshëm për efekte të masave organizative dhe administrative përgaditore hyn në fuqi menjëherë, ndërsa veprimtaria proceduriale penale në zbatim të tij fillon me 1 shtator 2020.

2. Ky udhëzim i përgjithshëm të publikohet në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme.

### **PROKUROR I PËRGJITHSHËM**

